



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 83/12
Prishtinë, më 23.11.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj dhe Sevdije Lama .

Mungoi: Albana Fetoshi.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Agim Krasniqi Drejtor i Departamentit të Buxhetit Qendror në Ministrinë e Financave, Alexander Beetz, Lukas Fischer, Ramadan Islami, Njomza Ilazi dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi , Dashurije Canolli, dhe Albulena Gashi.(praktikant).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit dt. 06.11.2012 dhe 13.11.2012;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013;**
4. **Shqyrtimi i Projektligji nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara, me Raportin me amendamente me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit dt. 06.11.2012 dhe 13.11.2012

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetarja theksoi se krahasuar me projektligjin e vitit 2012, janë shtuar përkufizime të reja dhe disa nene të reja dhe për aq sa kam vërejtur nuk ka ndryshime esenciale. Dje kam pranuar disa komente dhe sugjerime nga eksperti Juergen Schatz, angazhuar nga GIZ-i. Po ashtu edhe Ministria e Financave, përkatësisht drejtori i buxhetit ka njoftuar paraprakisht se ka disa propozime për ndryshimet teknike, në veçanti aty ku përmendet fjala program të zëvendësohet me fjalën nënprogram.

Më pas filloj shqyrtimi i projektligjit nen për nen. Preambula u miratuar pa ndryshime. Në nenin 1.1 kemi një propozim nga Ministria e Financave që në rreshtin e dytë fjala program të zëvendësohet me fjalën nënprogram.

Agim Krasniqi arsyëja e ndryshimit të fjalës program me nënprogram është si rezultat i sistemi të menaxhimit të pjesë tabelare të buxhetit, që buxhetimi ndahet sipas programeve e nenprogrameve, ndërsa në sistemi e mëhershëm struktura është ndarë në: ministria, departamenti, programet.

Miratohet ndryshimi në nenin 1.1, në rreshtin e dytë të përkufizimit “1.1. Buxheti i Republikës së Kosovës”, fjala “program”, zëvendësohet me fjalën “nënprogram”.

Kryetarja po ashtu në përkufizimin 1.31. *Transferet në rreshtin dytë dhe në fund të tekstit*, kemi një propozim që referenca 4.2, të zëvendësohet me referencën 4.1.

Agim Krasniqi sqaroi se edhe vitin e kaluar është bërë i njëjti gabim në referenca. Është një gabim teknik që është lëshuar dhe kemi propozuar që të përmirësohet në Komision.

Miratohet njëzëri ndryshimi në përkufizimi “1.31. *Transferet*”, ku në rreshtin e dytë dhe të fundit, referenca “4.2”, zëvendësohet me referencën “4.1”. Po ashtu njëzëri u miratua ndryshimi në nenin 4, ku në fillim të paragrafit 5, numri “5.5”, zëvendësohet me numrin “5”.

Latif Gashi desha të përshëndes drejtorin e buxhetit dhe qeverisë që në nenin 4 kanë bërë ndarjen e re të buxhetit për komunën e re të Mitrovicës dhe për sukseset që po shënohen në këtë drejtim.

Kryetarja po ashtu kemi propozim në nenin 7, në nënparagrafin 2.1, në rreshtin e dytë, fjala “program”, duhet të zëvendësohet me fjalën “nënprogram”. Si dhe në nënparagrafin 2.2, në rreshtin e dytë, fjala “Tabelës 3”, zëvendësohet me fjalën “Tabelës 3.2 dhe 4.2”.

Agim Krasniqi organizata buxhetore mund të mbesin në obligime se kur përgatitet draft buxheti nuk i kanë krejt të qarta sa do të realizohen projektet dhe mundet të planifikojnë të shpenzojnë me shumë se sa realisht me realizue, pra është fjala për obligimet e papaguara që barten në vitin vijues që të mos mbeten obligimet pa u përfunduar.

Miratohet njëzëri ndryshimi në nenin 7, dhe nënparagrafi 2.1, në rreshtin e dytë, fjala “program”, zëvendësohet me fjalën “nënprogram”. Ndërsa në nënparagrafin 2.2, në rreshtin e dytë, fjala “Tabelës 3”, zëvendësohet me fjalën “Tabelës 3.2 dhe 4.2”.

Hykmete Bajrami, kërkoi sqarime për nenin 9 nga drejtori i buxhetit.

Agimi Krasniqi sqaroi se kjo ka të bëj me fondin që ndahet nga fondi i Kosovës për RTK-në për minoritete dhe 5% e këtyre tarifave që i ka transmetuesi publik duhet të ndahen në harmoni me Ligjin për RTK.

Hykmete Bajrami neni 10 duhet të jetë më i specifikuar, pasi që ndoshta është komunë që është krijuar në vitin 2011, por nuk e ka kompletuar stafin dhe kështu si është po jepet mundësia me e rrit stafin deri 20% edhe nëse e ka të plotësuar stafin. Ne i dijmë apetitet e njerëzve për mbipunësim, sidomos kur kemi të bëjmë me zgjedhjet lokale në vitin 2013, dhe ka me u rritur numri i stafit prej 20% patën apo jo nevojë për punëtor.

Agimi Krasniqi është një arsye sepse ende nuk krijuar komuna në pjesën veriore të Mitrovicës me krejt kapacitetet e veta, momentalisht siq e dijmë është krijuar vetëm zyra administrative dhe dilema ka qenë a duhet me qenë vetëm viti 2012 a po edhe 2011 dhe në fund ka mbetur që duhet me qenë të dy vitet. Përndryshe komunat tjera të reja, pjesa më e madhe janë strukturuar.

Hykmete Bajrami a ekziston ndonjë ligj në fuqi që rregullon çështjen e ndarjes së buxhetit për komunat e reja dhe ndoshta me iu referuar atij ligji.

Agim Krasniqi ende nuk ka diqka të tillë, ndoshta duhet të mbetet vetëm 2012, sepse zyra administrative veç sa është krijuar.

Kryetarja mendojë që për vitin 2012 të mbetet dhe për vitin 2011 të hiqet. Ne duhet të kemi kujdes me punësimin e ri dhe ngarkesën e administratës publike përkundër nevojave për punësim.

Latif Gashi tanimë është linja buxhetore për zyrën administrative në Mitrovicë që e luan rolin e Komunës dhe ky është një realitet i ri. Sa i përket çështjes a do të jetë viti 2011 apo 2012, mendoj që kemi një ligj i cili përcakton kriteret dhe mbi bazën e të cilit ndahet buxheti për komunat dhe ligjet e njëjta duhet të vlejë për të gjitha komunat.

Agim Krasniqi ndarjet e buxhetit për komunat bëhen mbi bazën e formulës së granteve të përcaktuar në ligjin për financat e pushtetit lokal. Çfarë ne kemi propozuar me këtë nen është që në mungesë të bazës ligjore, të mbetet viti 2012 që krijon fleksibilitet që ka të bëjë me zyrën administrative, përkatësisht me themelimin e komunës së re të Mitrovicës.

Naser Osmani mundet me pas mospërputhje mes këtyre dy viteve, dhe komuna e zgjedh njëren apo tjetrën, të mbetet vetëm viti 2012 dhe të hiqet viti 2011.

Miratohet njëzëri ndryshimi në nenin 10, nënparagrafi 2.1, në rreshtin e dytë, fjalët “*vitet 2011, dhe 2012*”, zëvendësohen me fjalën “**vitin 2012**”.

Agim Krasniqi propozimi për ndryshimet në paragrafin 6 të nenit 10, ka të bëjë me rastin kur organizatat buxhetore nuk e shpallin tenderin deri me 1 nëntor dhe pretendon me krye organizata buxhetore për dy muaj e që në fakt proceduralisht nuk mundet të kryhet brenda vitit, vetëm nëse projekti është i vazhdueshëm dhe pjesë e tabelës për vitet vijuese.

Miratohet njëzëri ndryshimi në nenin 10 paragrafi 6, në rreshtin e katërt, fjala “*vitet 2013 apo 2014*”, zëvendësohet me fjalët “**vitin 2014**”.

Sali Asllanaj e kemi një propozim të ekspertit të GIZ që ka të bëjë me shpronësimet dhe është e rëndësishme që Kuvendi të jetë në dijeni për këto shpenzime kapitale dhe jam i pajtimit të pranojmë këtë sugjerim dhe të bëjmë amendament.

Agim Krasniqi ashtu si është propozuar nuk mundet të ndodh sepse nuk mundem as Kuvendit ti përcillen ato dokumente për informim. Nëse flitet për raportim këto informata ofrohen në raportet tremujore.

Naser Osmani qeveria parashikon shpenzimet për shpronësim në momentin e miratimit të buxhetit dhe këto janë shpenzime të qeverisë. Kuvendi me rastin e miratimit të buxhetit miraton edhe këto shpenzime.

Agim Krasniqi mjetet e shpronësimit janë të parapara në buxhet në projekte të caktuara dhe brenda organizatave që implementojn ato.

Sali Asllanaj interesimi im ishte që të ketë mbikëqyerje më të madhe nga ana e parlamentit për shpenzimet e pronësimit, të cilat janë tejkaluar jashtë mase dhe prapë kemi ankesa prej qytetarëve.

Kryetarja në raportet tremujore dhe vjetore jepen sqarime për të gjitha shpenzimet, përfshirë edhe shpenzimet e shpronësimit dhe mendoj se kësaj here është rregulluar mirë me këtë paragraf.

Naser Osmani nga përvoja që kemi patuar gjatë dëgjimeve buxhetore kemi mësuar se punonjësit e disa institucioneve dhe agjencioneve, sidomos atyre të pavarura marrin të ardhura përtej pagesës bazë në emër të shpërblimeve të ndryshme, të mëditjeve dhe shtesave tjera dhe na duhet të bëjmë një riformulim që ndalon marrjen e shtesave mbi 50% të pagës bazë.

Kryetarja në buxhetin e vitit të kaluar e patëm futur në dispozitë sipas së cilës organizatat buxhetore të institucioneve të pavarura që kanë pagat jashtë sistemit të shërbyesve civil, iu ndalohej të shfrytëzojnë të drejtën për shujta edhe rritjen prej 30 % sipas vendimit të qeverisë dhe ky propozim është hequr në buxhetin e vitit 2013, dhe ky nen nuk është zbatuar gjatë vitit të kaluar nga institucionet përkatëse.

Hykmete Bajrami nëse e kemi nenin në mundemi me i thirrur organizatat buxhetore dhe të paktën kur shqyrtojmë kërkesat me i thënë se ju nuk e keni zbatu ligjin, por nëse nuk ekziston fare neni, ata i kanë ende i kanë duart më të lira me marrë shtesa jashtë rregullave dhe jam pro kthimit të atij paragrafi.

Kryetarja mendojë që duhet të kthejmë atë pikë dhe të kërkojmë prej auditorit gjeneral të bëjë një auditim lidhur me këtë çështje për të gjitha institucionet dhe me shikue se çfarë po ndodh aty.

Miratohej njëzëri që në nenin 10, pas paragrafi 2 të shtohet paragrafi 3, me tekstin si në vijim: Punonjësit e Organizatave Buxhetore të Institucioneve të Pavarura që kanë pagat e tyre jashtë sistemit të pagave të shërbyesve civil, nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për shujta, kompensime të tjera dhe rritjen prej tridhjetë përqind (30%) sipas vendimit të Qeverisë.

Kryetarja nuk mund të bëhet propozime vetëm për institucionet e pavarura, sepse do të ketë reagim, por kjo duhet të vlejë për të gjithë të punësuarit në organizatë buxhetore që nuk mund të marrin shtesa që kalojnë 50% të pagës bazë.

Agimi Krasniqi duhet të veçuar fondin për kuadra, që janë ekspertët për raste specifike që angazhohen.

Naser Osmani ti fusim të gjitha institucionet, peveq fondit për kuadra.

Kryetarja duhet të bëhet një paragraf i ri që përcakton këtë çështje, por të analizohet mirë që mos të biem në kundërshtim me ligjet tjera.

Naser Osmani sa i përket nenit 12 mendojë se është dashur që në fillim mjetet të barten në komuna f sepse është fjala për infrastrukturë rrugore dhe jo të bëhen më vonë, pasi që çështja memorandumit të mirëkuptimit është formale dhe meqë nuk janë bërë planifikimet nga komunat, atëherë projektet të realizohen nga ministrinë përkatëse.

Sali Asllanaj ka të bëjë me fondin me bashkëfinancim në mes komunave dhe qeverisë dhe qëllimi është të lihet një fleksibilitet për ministrinë dhe komunat dhe kjo ka justifikim.

Naser Osmani fjala ime ka të bëjë me atë që le të respektohet planifikimi i cili është i projektuar në buxhet, se pastaj po na dalin telashe edhe tani po vjen ne shprehje kush është më i forti.

Agim Krasniqi qëllimi i këtij neni është që përmes dy ministrive, investimeve që ndahen në ministri me pas një zhvillim më harmonik të barabartë në komuna.

Latif Gashi realisht me sa kemi informacione është një buxhet i cili është ndarë me përkrahje, një buxhet të të gjitha komunave dhe është i shpërndarë në mënyrë të barabartë.

Sali Asllanaj po ju siguroj që mjetet më mirë menagjohen nëpër komuna se sa në nivelin qeveritar. Duhet me bo çdo gjë me specifikimin obligimin e qeverisë për shpenzimin e fondit, dhe siç u tha një zhvillim harmonik, pasi që disa komunat kanë nevojë më shumë për participim në realizimin e projekteve.

Kryetarja është bashkëfinancim që realizohet përmes memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar nga palët respektive dhe secila e paguan pjesën e vetë të participimit në realizimin e projektit.

Hykmete Bajrami nëse projekti e ka një kod në komunë, e nuk ka kod në ministri të infrastrukturës, nëse nuk ja transferon paratë komunës nuk ka mundësi me u bë pagesa teknikisht. Ne kemi kërkuar që edhe rrugët apo shkollat që bëhen në komuna të realizohen nga komunat dhe kemi thënë se është shkelje e ligjit për financat lokale dhe për arsimin lokal kur ndërton ministria në komuna, do të thotë duhet realizuar në bazë të formulave, dhe investimet kapitale të kalojnë në komuna dhe ti realizojë komuna.

Sali Asllanaj mos të mirrem me çështje teknike, por me rëndësi është që fondi me u realizue edhe me ju ndihmu disa komunave në zhvillim, e dyta në procedurë të tenderimit, komisioni formon bashkëpunim me komunën dhe ministrinë që ka ndodhur shpesh në praktikë.

Njëzëri miratohet ndryshimi në nenin 10 paragrafi 7, në rreshtin e parë, pas fjalës “shpronësimin”, shtohet fjala “**për projekte të veçanta**” dhe në paragrafin 8 i numëruar si paragrafi 9, në fillim të nënparagrafit 1, numri “81”, zëvendësohet me numrin “**9.1**”.

Miratohen njëzëri ndryshimet në nenin 12, paragrafi 1, në rreshtin e parë, fjala “programit”, zëvendësohet me fjalën “**nënprogramit**”, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, fjala “programi”, zëvendësohet me fjalën “**nënprogrami**”, po ashtu në rreshtin e njëjtë fjala “program”, zëvendësohet me fjalën “**nënprogram**”, dhe në rreshtin e fundit fjala “programit”, zëvendësohet me fjalën “**nënprogramit**”.

Naser Osmani neni 13 drejtor ka të bëjë edhe me rishikim i buxhetit në njëfarë mënyre?

Agim Krasniqi ne i kemi dhënë drejtën ministrit, respektivisht qeverisë që në rast se në tre mujorin e fundit organizata buxhetore nuk është në harmoni me planin e shpenzimeve atëherë ato fonde, me i marrë dhe me i përdorë në rradhë të parë brenda organizatës buxhetore. Dhe e dyta në rast se ka fonde brenda një organizate më shumë se sa ka shpenzuar, atëherë ato fonde në projekte të caktuara me pas të drejtën me i marrë edhe me i vendos aty ku ka mungesë të mjeteve.

Kryetarja këtu është fjala për 5% i të gjithave ndarjeve buxhetore dhe jo më shumë, një sqarim për këtë drejtor?

Naser Osmani a është fjala vetëm për mallra e shërbime, apo përfshin edhe kategoritë tjera ekonomike deri në 5%?

Agim Krasniqi është fjala për të gjitha kategoritë ekonomike.

Kryetarja neni po thotë shkurtimet e ndarjeve buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike të asaj organizate buxhetore qendrore, dhe nuk po përmend institucioneve të pavarura apo ato lokale.

Agim Krasniqi të gjitha konsiderohen institucioneve të pavarura, përveç që nuk lejohet ndërhyrja në buxhetin e komunave sipas ligjit.

Kryetarja ndoshta do të ishte mirë të specifikohet se edhe institucionet e pavarura mund t'iu bëhen shkurtim apo mund të hiqen nga shkurtimi, sepse në çdo raport vjetor që kemi pranuar nga këto institucione cek faktin e shkurtimeve nga qeveria dhe e ekzagjerojnë problemin deri ku nuk duhet.

Agim Krasniqi nëse mendoni të precizoni, atëherë duhet të thuhet kjo vlen për gjitha organizatat buxhetore me përjashtim të organizatave buxhetore lokale

Hykmete Bajrami te pika 4 e nenit 13 kemi një sugjerim prej Jurgenit.

Agim Krasniqi kjo ka të bëjë psh. kur ministria e financave ka nevojë ndonjëherë me bë rregullime të brendshme dhe mund të ketë avancim në sistem dhe thuhet që është normale të lëviz një koeficient apo gjysmë koeficienti te punëtorët edhe kjo nënkupton se vetëm këtë rregullim ka drejtë me bë ministri dhe asgjë tjetër.

Kryetarja a është fjalë brenda kategorisë së pagave dhe mëditjeve, apo secili ministër mundet me bë këtë lëvizje? Dhe në rast se ministritë tjera kanë kërkesa të tilla, si realizohet kjo?

Agim Krasniqi këtë të drejtë e ka vetëm ministri i financave. Ministritë tjera duhet të iu drejtohen ministrit të financave për lehtësimin e këtij ndryshimi.

Miratohen ndryshimet në nenin 13, paragrafi 2, në rreshtin e katër pas fjalës “*transferoj atë*”, shtohet teksti “**brenda po të njëjtës organizatë buxhetore apo të transferoj atë**”. Në rreshtin e gjashtë pas fjalës “buxhetore”, shtohet teksti “**me përjashtim të paragrafit 6 të nenit 10 të këtij ligji**”. Ndërkaq në paragrafin 4, në rreshtin e dytë, fjala “*programeve*”, zëvendësohet me fjalën “**nënprogrameve**”, si dhe në paragrafin 5, në rreshtin e parë pas fjalës “buxhetore”, shtohet teksti “**me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni**”.

Kryetarja te neni 13, paragrafi 3 kemi një propozim të ministrisë që në rreshtin e fundit pas fjalës “nën-program”, të shtohet teksti “me përjashtim të paragrafit 2 të nenit 13, kur ministrit i lejohet të bëjë një

transfer të tillë, pas shkurtimeve buxhetore me miratim të Qeverisë.”

Agim Krasniqi ky propozim ka ardhur si rezultat i rekomandimeve të auditorit që ne i kemi marrë, që mos të ketë ndryshime në mes paragrafëve të caktuar të ligjit.

Hykmete Bajrami a është neni në këtë tekst të cilin e kanë harmonizuar edhe vitin e kaluara në bazë të së cilit janë bërë lëvizjet e projekteve kapitale dhe janë shkurtuar për 85 projekte apo janë hequr me përqindje të caktuar?

Agim Krasniqi kjo ka të bëjë me ndryshimet në janar që ndodhin dhe nuk ka të bëjë me muajin tetor apo nëntor.

Miratohen njëzëri ndryshimet në nenin 14, paragrafi 3, në rreshtin e fundit pas fjalës “nën-program”, shtohet teksti “me përjashtim të paragrafit 2 të nenit 13, kur ministrit i lejohet të bëjë një transfer të tillë, pas shkurtimeve buxhetore me miratim të Qeverisë.”

Sali Asllani sa i përket nenit 20, jam kundër projektit të autostradës për Ferizaj, dhe kjo që po ndodh është niveli i shpenzimeve të buxheti të Kosovës dhe gjendja ekonomike është dërrmuar me këto shpenzime në autostradave duke lënë anash shumë investime pa bërë. Jam parimisht kundër këtij projekti sepse e konsideroj se e kemi ndërtuar autostradën e kombit dhe i kemi dhënë një prioritet forcave shqiptare, mos të tërhiqemi kah Maqedonia apo Greqia.

Latif Gashi për PDK vërtetë është një barrë e rëndë të realizohen këto projekte jetike për Kosovën dhe është një barrë shumë e madhe, por se pa u ndërtue rrugët, ne nuk kemi me pas zhvillim ekonomik.

Naser Osmani neni 20 kushtëzon fillimin e autostradës Prishtinë-Shkup deri sa bilanci bankar të arrihet 300 milion euro, por nëse e heqim këtë nen autostrada mund të filloj prapë edhe më pak mjete. Prandaj ky është kusht që kushtëzon fillimin e punimeve deri në arritjen e nivelit të caktuar të bilancit bankar.

Hykmete Bajrami në tekst nuk thuhet asgjë për shitjen e Postës, si dhe të hyrat prej shitjes së distribucionit të KEK-ut nuk janë askund. Ne kemi shfaq opinionin tonë si parti dhe kemi thënë se qeveria nuk ka bazë ligjore me e shit PTK dhe nuk ka bazë ligjore me i pas ato të hyra të njëhershme prej 300 milion euro. Dhe kjo nuk është trajtuar në pjesën tekstuale por janë përfshirë si të hyra të njëhershme në tabelën numër 1, që konsiderojmë se është gabim dhe nuk ka bazë ligjore ashtu si është rregulluar.

Agim Krasniqi pjesa tekstuale dhe tabela numër 1 janë çështje te ndara. Është një kusht nga FMN –ja, se përndryshe se kishim futur fare të hyrat e njëhershme në tabelë 1.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisionit me tri vota Kundër (Naser Osmani, Sali Asllanaj dhe Hykmete Bajrami), Asnjë Abstenim dhe shtatë vota Për (Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj) nxori këtë

Rekomandim

Miratohet raporti me amendamente për pjesën tekstuale të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovëës për vitin 2013.

4. Shqyrtimi i Projektligji nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara, me Raportin me amendamente me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja nga vlerësimi i deklaratës financiare dhe nga analiza që iu është bërë projektligji, shifet se nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi: 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj